

REPUBLIKA E KOSOVË/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËSVLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 08-3308/4
Data/Datum/Date: 24/09/2020
Shitja/Dodaci/Annex: 3
PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë/Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Departmant Slobodnih Profesija - Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/ The Disciplinary Committee

Nr.01//2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUES PRIVAT, në përbërje të Xhemil Elshani kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha anëtarë, në çështjen disiplinore ndaj

, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367 par.1 nën par.1.1, 1.2 dhe 1.4 të LPP-së, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ MD.nr.09/2014, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë për profesionet e lira- Divizioni për Noteri dhe Përmbarues privat Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, të palës ankuese Valentina Hyseni nga Podujeva, të cilin e përfaqëson av.Qendrim Rama nga Skenderai, si dhe

as mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim të mbajtur me dt. 22.06.2020, muar këtë:

V E N D I M

I. Organi Përmbarues – , i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 365 par.1, neni 367 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.4 të LPP-ës.

II. Për shkeljen disiplinore të kryer, nga Organi përmbarues – nga Gjakova, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë i shqiptohet masa disiplinore **vërejtje**, në bazë nenit 368 par.1 pika 1.1 të LPP-së.

A r s y e t i m

Ministria e Drejtësisë, - Departamenti për Profesione të Lira – Divizioni për Noterin dhe Përmbarues Privat, bazuar në ankesën e propozuesit Valentina Hyseni nga Podujeva të autorizuarit të saj av.Qendrim Rama nga Prishtina të dt.31.12.2019 dhe 09.01.2020 dhe ate me dt.05.02.2020, ka paraqitur propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj Organit përmbarues – nga Gjakova, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e

Gjykatës Themelore në Gjakovë, si i dyshuar për shkak të shkeljeve disiplinore gjatë ndërmarrjes së veprimeve procedurale përmbarimore, sipas lëndës përmbarimore P.nr.559/19, ashtu që ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit të procedurës përmbarimore, dhe udhëzimit administrativ përkatësisht ka bërë caktimin e daljes në vend të ngjarjes përkitazi me sekuestrimin e koletaralit të garantueses Valentina Hyseni, propozueses në këtë rast, në kundërshtim me marrëveshjen paraprake me palën debitorë dhe kreditore, ku përmbaruesi privat fare nuk e ka pruar urdhërin për përmbarim dhe as që e ka njoftuar palën debitorë – garantuesen. Prandaj bazuar në këtë përmbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore në kuptim të nenit 367 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.4 të LPP-ës.

Në kuptim të dispozitave të nenit 4 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MD.nr. 09/2014, komisioni disiplinor ka caktuar seancën dëgjimore, me dt. 22.06.2020 në ambientet - zyrat e Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën seancë kanë marrë pjesë të gjitha palët në procedurë si ankuesja - Valentina Hyseni nga Podujeva, të cilën e përfaqëson av.Qendrim Rama nga Skenderaj,

si dhe përf. i Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për profesionet e lira – Divizioni për Noterin dhe Përmbaruesit privat Fadilete Hoxhaj në cilësinë e iniciuesit të procedurës disiplinore.

Komisioni disiplinor, me qëllim të vërtetimit të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike ka bërë dëgjimin e të gjitha palëve në procedurë, shqyrtimin e provave përmes leximit të të njëjtave, ashtu edhe të shkelësit disiplinor- përmbaruesit privat në pajtim me nenin 7. par. 5 të UA-MD.nr. 09/2014.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me dt. 22.06.2020 kryesuesi i komisionit disiplinor, në fillim të seancës dëgjimore ija ka dhënë mundësinë shkelësit disiplinor respektivisht

që të deklarohet lidhur me përgjegjësinë disiplinore për pranimin e përgjegjësisë, në pajtim me nenin 7 par. 3 UA- MD.nr. 09/2014, për procedurën disiplinore me çrrastë përmbaruesi privat ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduar.

Pasi që përmbaruesi privat nuk e ka pranuar përgjegjësinë disiplinore për shkeljen e pretenduara, pas kësaj procedura dëgjimore ka vazhduar me përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë duke e shtjelluar propozimin dhe provat tjera përkitazi me çështjen në fjalë, si dhe parashtrimin e propozimit për procedurë disiplinor ndaj organit përmbarues _____, si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, i dyshuar për shkelje të veprimeve disiplinore nga neni 367 par. 1 nën par. 1.1, 1.2 dhe 1.1.4 të LPP-ës.

Përmbaruesi private në përgjigjen e tij me shkrim të dt.10.02.2020, ndaj propozimit të ankueses për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij ka deklaruar se ankesa e Valentina Hysenit fare nuk është e nënshkruar nga ajo e as i autorizuar i saj dhe e njëjta ankese përmbar të meta të tjera që kjo ankese fare nuk duhet të mirret në shqyrtim. Konsiderojë se pretendimet e të njëjtës për shkelje të pretenduara janë të pa bazuara pasi që pala është njoftuar me procesverbal se pengun i është dorëzuar kreditorit dhe se kreditori ka marr pengun në posedim dhe ka patur të drejtën e shitjes së të njëjtit për realizimin e kërkesës. Andaj propozojë që ankesa e debitores Valentina Hyseni e

ushtruar nga ana e avokatit Qerim Rama, për iniciimin e procedurës dicitpline ndaj meje të refuzohet si e pa bazuar në tërësi.

Pala ankuese si dhe i autorizuari i saj, sikurse në propozim – ankesë për fillimin e procedurës dicitpline edhe në seancën dëgjimore ka deklaruar se mbesë në tërësi si në ankesë duke pretenduar se përmbartuesi privat ka bërë shkelje dicitpline – ligjore materiale dhe procedurale, e të cilat shkelje kanë rezultuar me pasoja të dëmtuara Valentina Hyseni. Me veprimet e lartëpërmendura të theksuara më lartë përmbartuesi privat ka qenë i njëanshëm dhe jo profesional, dhe me këto veprime ka bërë edhe shkelje të kodit të etikës. Dhe kërkoj nga komisioni dicitplinor që përmbartuesi privat, i njëjti të shpallet se është përgjegjëse për shkeljet dicitpline dhe të njëjti të shqiptohet masa dicitpline e paraparë me nenin 368 të LPP-së, nga se i njëjti gjatë veprimeve procedurale – përmbartimore ka urdhëruar për lehtësimin e përmbartimit me sekuestrim të pengut, pamvarësisht marrëveshjen paraprake që kanë patur me palën debitorë për shtyerje të seancës për sekuestrim, pa e njoftuar paraprakisht palën debitorë – garantuesen në këtë rast ankuesen, me propozimin për përmbartim, dhe as pa ju dhënë mundësia debitorës – garantueses në këtë rast ankueses për parashtrim të prapësimin ndaj urdhrit për përmbartim.

Gjatë seancës dëgjimore të dt. 22.06.2020 i deklaruar se sa i përket deklarimeve të ankueses deklarohet se përmbartuesi privat lidhur me këtë çështje juridike nuk ka bërë asnjë shkelje dicitpline për përmbartimin e çështjes P.nr.559/19, respektivisht në tërësi ka deklaruar si në përgjigjen me shkrim të dt.10.02.2020.

Komisioni dicitplinor pas vlerësimit të provave të shqyrtimit të të njëjtave si dhe dëgjimit të gjitha palëve në procedurë, ka vendosur që ndaj , nga Gjakova të shqiptohet masa dicitpline “vërejtje” si është përmendur në dispozitiv të këtij vendimi për shkak se është përgjegjëse për shkelje dicitpline nga neni 365 par. 1 të LPP-së. e cila masë është në proporcion me shkeljen e kryer dicitplinor dhe e mjaftueshme tani për tani, dhe se kjo masë do të shërbejë përmbartuesit privat të lartëpërmendur, si organ përmbartues në këtë çështje përmbartimore që të jetë në të ardhmen më i kujdesshëm, tu përmbahet në përpikëri zbatimit të dispozitave ligjore gjatë zbatimit të përmbartimit, në cilën do çështje përmbartimore që do të paraqitet para përmbartueses.

Andaj më sa u tha më lartë e duke vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 365 par.1, neni 367 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.4 të LPP-së, dhe nenit 368 par. 1, pika 1.1 të LPP-së, komisioni dicitplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL. nr. 01/2020 të dt. 22.06.2020

Kryetari i Komisionit Disiplinor

Xhemil Elshani

KËSHILLI JURIDIK : Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar sipas nenit 374 par. 5 të LPP-së.